



REPUBLIKA E SHQIPÉRISË

UNIVERSITETI I TIRANËS

FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA

RREGULLORE PËR KONFERENCAT SHKENCORE

Miratuar me Vendimin e Dekanatit

Nr. 33 datë 07.06.2023



Organizimi i konferencave shkencore në FGJH mbështetet në një seri aktesh rregullatore si Strategjia e kërkimit shkencor në FGJH, miratuar me vendim nr. 135, datë 20.12.2022, Rregullorja e brendshme e UT-së miratuar me vendim nr. 20, datë 27.07.2022, si dhe Rregullorja e brendshme e FGJH-së.

Neni 1

- 1. Konferencat shkencore në FGJH organizohen në dy nivele: në nivel të Njësisë Kryesore (Fakulteti) dhe në nivel të njësisë bazë (Departamentit)**
 - a) Në nivel Fakulteti: konferenca shkencore vjetore (kombëtare ose ndërkontinentale) organizohet nga Dekanati, i cili ngrë për këtë qëllim një grup pune me përfaqësues nga të gjitha departamentet. Konferenca vjetore e FGJII-së, zhvillohet me pjesëmarrje të IAL-ve vendase dhe universitetet e huaja partnere si dhe në bashkëpunim me qendra kërkimore vendase.
 - b) Përgjegjës kryesor për organizimin e grupit të punës, përgatitjen dhe mbarëvajtjen e Konferencës, është zv.dekani për kërkimin shkencor.
 - c) Në nivel departamenti/dege mund të organizohen deri në dy konferenca (kombëtare ose ndërkontinentale). Në këtë rast konferencat organizohen me nismën e grupit mësimor-kërkimor ose një anëtarë të departamentit, të cilët e shtrojnë propozimin në departament dhe vendosin së bashku për të.
 - d) Në nivel të disa departamenteve: konferencat mund të organizohen edhe në bashkëpunim të dy apo më shumë departamenteve. Në këtë rast, nisma merret ose nga grupet kërkimore-shkencore homologe ose anëtarë të departamenteve dhe shtrohet për diskutim e miratohet nga departamentet e interesuara.
- 2. Konferencat e organizuara në nivelet e lartcitura i rezervojnë sipas rastit një sesion të veçantë doktorantëve dhe studentëve që ndjekin studimet Master.**



Neni 2

Sipas nenit 66 të Rregullores së brendshme të FGJH-së dhe nenit 87 të Rregullores së bendshme të UT-së, zhvillimi i konferencave rregullohen si më poshtë:

1. Jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë përpara përfundimit të vitit buxhetor, departamentet propozojnë konferencat shkencore që do të zhvillojnë, gjatë vitit të mëpasshëm buxhetor.
2. Propozimi duhet të përmbajë llojin e konferencës (ndërkomëtare apo kombëtare), mënyrën e organizimit të saj dhe periudhën e përafërt kur mund të zhvillohet, si edhe kostot përkatëse
3. Propozimi i përcillet dekanatit që vendos për miratimin e tyre në buxhetin përkatës. Në miratimin për organizimin e konferencave shkencore, Dekanati duhet të ruajë parimin e barazisë midis njësive bazë.
4. Për konferencat e miratuara, Dekanati (për konferencën vjetore) ose Departament-i/t et (për konferencat e tyre) ngrëjnë një komitet shkencor dhe një komitet organizativ detyrat e të cilëve përcaktohen si më poshtë:
 - a) Komiteti shkencor harton thirrjen për konferencën dhe përbajtjen dhe elementet e posterit si dhe është përgjegjës për pranimin e ligjératave të pjesëmarrësve në bazë të gjykimit të abstrakteve të depozituara.
 - b) Komiteti shkencor lajmëron aplikantët për referim 1 muaj përpara për pranimin e abstrajteve
 - c) Komiteti organizativ përcakton modalitete e njoftimit të thirrjes, të paraqitjes e të vlerësimit të abstrakteve, referimeve të paraqitura, caktimit të relatorëve, plotësimit të vërejtjeve të relatoëve, llojet dhe kriteret që duhet të plotësojnë abstraktet, referimet, referencat shkencore etj.
 - d) Çdo kumtesë e rëfrojua para se të batolet duhet të lexohet nga dy relatorë anëtarë të komitetit shkencor dhe të ketë vlerësim të shkruar prej tyre. Kumtesa për vlerësim duhe te jetë anonime.
 - e) Komiteti organizativ është përgjegjës për mbajtjen e kontakteve me referuesit, përgatitjen e dosjeve të tyre, regjistrimin ditën e zhvillimit të konferencës si dhe për funksionimin logistik (gatishmërinë e kompjuterave, mjeteve të tjera që lehtësojnë zhvillimin normal) dhe mbarëvatjen e konferencës në të gjitha aspektet. Në përfundim të konferencës, komiteti organizativ është përgjegjës për mbledhjen dhe menaxhimin e ligjératave që do të botohen.



Neni 3

Hartimi i thirrjes së konferencës dhe i abstrakteve rregullohen sipas modalitetave të mëposhtme:

- a) Thirrja duhet të përbajë titullin e konferencës, argumentin e saj, qëllimet e objektivat të artikuluara në akse studimi (të cilat orientojnë më pas ndarjen në seksione), eventualisht edhe bibliografinë orientuese.
- b) Abstraktet duhet të përbajnë rreth 200 fjalë ku të shpjegohet qëllimi i ligjërâtës, objektivat dhe përfundimet ku synohet të arrihet si dhe fjalët kyç. Abstrakti përgatitet në gjuhën shqipe dhe atë anglaze

Neni 4

Thirrja e konferencës në nivel department-i/esh duhet të njoftohet 3- 6 muaj para zhvillimit të saj dhe në nivel të Njësisë kryesore, 6-12 muaj.

Neni 5

Aktet e konferencave duhet të botohen në mënyrë të përshtatshme, në format letër ose në format elektronik, si edhe të pajisen me ISBN. Kur aktet e konferencave shkencore botohen në revistat shkencore ato pajisen me ISSN e revistës.

Neni 6

Bazuar në nenin 118 të Statutit të UT-së Struktura organizative e Konferencës (Njësia kryesore ose/dhe Njësia bazë) mund të vendosë një tarifë për pjesëmarrësit, e cila ka si qëllim mbulimin e kostove administrative apo ato të botimit të akteve

